



Tiranë, me 18/06/ 2021

Lenda: Kerkese per heqjen e barrierave qe pengojne mbarevajtjen e sezonit turistik

Drejtuar:

Znj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Znj. Mira Rakacolli ,Drejtoreshë e Komitetit Teknik te Eksperteve

Per dijeni,

Z. Blendi Klosi, Minister i Turizmit dhe Mjedisit

Te nderuar zoterinj Ministra,

E nderuar znj. Drejtoreshë e Komitetit Teknik te Eksperteve

Ne përfaqësuesit e sipërmarrjeve private, nën grupimin e **Unionit Turistik Shqiptar**, shoqata me e madhe e industrise se turizmit,e cila qe nga viti 2005 e ne vazhdim perfaqeson mbi 250 subjekte, Operatore Turistik,Hotele,Agjenci Udhetimi, Guida, Restorante,Transport turistik, e tj,nepermjet kesaj letre duam te ju shprehim shqetesimin tone,i cili ka te beje me disa barriera qe po behen pengese per mbarvajtjen e sezonit,sic jane; mbajtja ne fuqi e ores policore, nga 23: 00 deri në oren 6:00,mos lejimi i muzikes ne lokale pas ores 22:00 dhe mos lejimi i eventeve mbi 50 persona.

Ne pershendesim vendimin e qeverise per te lejuar hyrjen ne Shqiperi te turisteve pa test dhe pa karantine,vendimin per vaksinimin te sektorit te turizmit, vendimin per hapjen e 28 qendrave shëndetësore verore, në zonat tursitke, dhe njekohesisht



vleresojmë mbështetjen tuaj për lehtësimin e disa masave kufizuese si: heqjen e maskave në ambientet e jashtme, lejimin e grumbullimeve deri në 50 persona, lejimin e konferencave me kapacitet të reduktuar deri në 30%”, por jemi të mendimit se në kushtet aktuale duhet rishkuar mundësia për zgjerimin e këtyre masave në mënyrë që të ndihmohen bizneset dhe njëkohësisht të krijohen kushtet për arzetim turistik që kanë zgjedhur Shqipërinë për të kaluar pushimet e tyre, pasi kjo do shtonte kërkesën dhe do bente e mundur rritjen e numrit të turistëve që do vijne në Shqipëri, gjë e cila do kontribuonte në rritjen e të ardhurave për ekonominë tonë.

Sic jeni në dijeni shumë vende Europiane, përfshirë edhe fqinjët tanë, me qëllim që të mos shkaktojnë barrierë gjatë sezonit turistik kanë hequr oren policore, lejojnë organizimin e eventeve në ambiente të hapura, tarraca, veranda, oborre deri në maksimum 100 persona, por jo më shumë se 50 për qind e kapacitetit të hapësirës, lejojnë muzikën gjatë organizimit të eventeve, në pajtim me protokollin adekuat dhe brenda nivelit të zhurmave, duke garantuar komoditet për çdo pushues vendas dhe të huaj.

Duam t’ju bejme me dije se ne, si sipërmarrës, ndajmë të njëjtat shqetësime e përgjegjësi dhe jemi të vetëdijshëm për seriozitetin e situatës në të cilën ndodhemi, por njëkohësisht theksojmë se në kushtet aktuale kur situata është përmirësuar ndjeshëm, mendojmë që këto masa shtrënguese duhen hequr, pasi ndikojnë dukshëm në mbarvajtjen e biznesit dhe po krijojnë probleme edhe në respektimin e marrëveshjeve me operatorët ndërkombëtarë që furnizojnë vendin tonë me turistë. Po ju përmend disa shembuj konkretë, të cilat kanë pasur një ndikim negativ dhe na kanë krijuar probleme me partnerët ndërkombëtarë;

1. Për shkak të kufizimit të levizjes nga mesnata deri në orën 6 të mëngjesit po krijohen pengesa në mundësimin e shërbimeve të partnerëve ndërkombëtarë të cilët operojnë me fluturime charter në aeroportin e Rinasit, pasi një numër i këtyre charterave mberrijnë pas orës 12:00 të natës dhe sipas marrëveshjeve, të gjithë turistët



Albanian Tourism Union
Unioni Turistik Shqiptar

(Shoqate jo qeveritare e regjistruar me vendim gjykate nr 1280 date 23.02.2005)

duhet qe te priten ne aeroport nga delegatet e autorizuar prej tyre, te cilet jane shtetas te oregjines se turisteve, qe presin, oreientojne dhe ju japin kontaktet turisteve te tyre per problemet qe mund te kene gjate qendrimin ne shqiperi, keto persona udhetojne me makina qe marrin me qera nga aeroporti dhe per ne aeroport dhe rregullisht ndalohen nga policia e cila ne mjaft raste i ka penalizuar.

2. Per shkak te moslejimit te muzikes pas ores 22:00 kemi marre shume ankesa nga turistet te cilet jane te pakenaqur ngaqe nuk kane ardhur per tu mbyllur ne dhome, po per te pushuar dhe per tu argetuar, me qellim qe turistet te marrin kenaqesine e pushimeve, sugjerojme qe ky orar te zgjatet deri ne oren 24:00 ne menyre qe te mos u shkaktohet merzitje turisteve, pasi ora 22 nuk mjafton duke pasur parasyshe faktin qe gjate periudhes se veres kjo ore eshte koha qe erresohe dhe gjate dites njerzit jane ne pune dhe darkat ngelen me te frekuentuara nga qytetaret.

Me qellimin e mire per te ndihmuar bizneset, por njekohesisht per te krijuar kushte dhe per zbatimjen e turisteve te cilet kane zgjedhur Shqiperine per te pushuar po ju drejtohem juve , qe te merrni ne konsiderate propozimet tona.

Duke besuar ne qasjen tuaj pro turizmit mbetemi ne pritje te nje reagimi pozitiv nga ana juaj

Ju falenderoj paraprakisht per mirekuptimin dhe bashkepunimin

Në emër të bizneseve të “Unionit Turistik Shqiptar”

Kryetari

Rrahman Kasa



Sheshi Skenderbej, Pallati i Kultures nr 43, Tirane

Tel: +355 4 2239004. Mob: +355 (0) 682002508 e-mail: info@atu.org.al web: www.atu.org.al